

# SISTEMI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE I BAZUAR NË OZHQ





Autor: INDEP

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Mars, 2023

Dizajni: KUKU Creative



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndalet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

---

# Hyrje

Komunat paraqesin njësitë themelore të vetëqeverisjes lokale. Si të tilla, komunat janë të obliguara të ofrojnë shërbimet bazë për qytetarët e tyre. Komunat e Republikës së Kosovës kanë pak më shumë se 20 vite që qeverisen në mënyrë demokratike, dhe përgjatë kësaj periudhe kanë bërë hapa mjaft të shpejt drejt avancimit të shërbimeve, digjitalizimit, konsolidimit demokratik dhe transparencës.

Përveç obligimit themelor ndaj qytetarëve të komunave përkatëse, disa prej shtytësve kryesore të avancimit të performancës së komunave kanë qenë proceset shtetformuese dhe të integritit Euro-Atlantik nëpër të cilat ka kaluar dhe po kalon Kosova. Zbatimi i një Kushtetutue multietnike me të drejta dhe privilegje të theksuara për komunitetet pakicë, procesi i decentralizimit, përmbushja e kriterëve për integrim evropian dhe të tjera.

Një nxitës tjetër i rëndësishëm në avancimin e performancës dhe ofrimit të shërbimit nga komunat është Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPM). Për shumë vite ky Sistem është vërtetuar të ketë efekt pozitiv duke nxitur komunat të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët, të jenë më konsultantive dhe gjithëpërfshirëse në hartim të politikave dhe marrje të vendimeve, si dhe të jenë më transparent.

Në anën tjetër, përveç zotimeve dhe obligimeve të integritit Euro-Atlantik që ka marrë Kosova, zhvillimet globale politike, industriale e natyrore kanë bërë që organizatat ndërkombëtare dhe supranacionale të miratojnë dokumente udhërrëfyese për të adresuar sfidat bashkëkohore. Dokumente të tilla janë Marrëveshja e Gjelbër Evropiane (European Green Deal) miratuar nga Bashkimi Evropian dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), miratuar nga Kombet e Bashkuara.

Komunat e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrin hapa që të përfshijnë edhe synimet e këtyre dy dokumenteve gjatë punës së tyre. Një pjesë të konsiderueshme të këtyre synimeve komunat i zbatojnë në punët e tyre të përditshme dhe një numër i vogël i tyre mbulohet nga indikatorët e SMPM, por për pjesën më të madhe të OZHQ-ve mungon monitorimi i zbatimit dhe raportimi.

Ky punim do të bëjë krahasimin dhe analizimin e mundësisë së përfshirjes së një numri të indikatorëve për raportim të OZHQ-ve brenda SMPM-së. Fillimisht, punimi do të tregojë lidhmërinë ndërmjet SMPM-së, OZHQ-ve dhe kriterëve për integrim evropian, më pas do të krahasojë përputhshmërinë e një numri të indikatorëve të SMPM-së dhe ata të OZHQ-ve, dhe do të propozojë përfshirjen e një numri të indikatorëve të OZHQ-ve, të cilat janë në kompetenca të komunave, brenda SMPM-së.

## Ndërlidhja e politikave kombëtare, lokale me integrimet euro-atlantike

Republika e Kosovës është e përkushtuar ndaj vlerave liberal-demokratike dhe orientimit perëndimor. Rrjedhimisht, institucionet e Republikës së Kosovës kanë bërë prioritet integrimin në Bashkimin Evropian. Po ashtu Kosova është zotuar edhe për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) përmes themelimit të Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm, brenda Kuvendit të Kosovës, në vitin 2018 si dhe tani me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZH), e cila është në fazën finale të miratimit.

Edhe Marrëveshja e Gjelbër Evropiane (MGJE) paraqet një udhërrëfyes të politikave për të adresuar ndryshimet klimatike dhe për të transformuar BE-në “në një shoqëri të drejtë dhe me prosperitet”. Si e tillë, MGJE “është pjesë integrale e strategjisë së Komisionit Evropian për të zbatuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara”.<sup>1</sup>

Një studim i përbashkët i bërë nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka konstatuar lidhmërinë ndërmjet 35 kapitujve për anëtarësim në BE dhe OZHQ-ve.<sup>2</sup> Në ilustrimin djathtas, është dhënë një tabelë e shkëputur nga ky studim që tregon se shumica e 35 kapitujve prekin katër apo më shumë Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh se edhe MGJE është pjesë e strategjisë së BE-së për zbatim të OZHQ-ve, i bën të tri këto procese komplementare për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Komunitat kryejnë një pjesë të konsiderueshme të zbatimit të

obligimeve që dalin nga procesi i integritimit evropian dhe për këtë raportojnë përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal. Mirëpo, derisa për kërkesat që dalin nga procesi i integritimit në

Figure 2: Kosovo's 2030 agenda and EU agenda: areas of commonality



<sup>1</sup> Shih: Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, publikuar me 11 dhjetor 2019, COM (2019) 640

<sup>2</sup> Shih: <https://kosovoteam.un.org/index.php/en/137026-maximising-synergies-between-2030-agenda-and-kosovos-european-agenda>

BE institucionet mbledhin informata dhe raportojnë rregullisht, në rastin e OZHQ-ve kjo mungon.

Pavarësisht nivelit të politikave, qofshin ato në nivel të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian apo të shtetëror, një pjesë e barrës së zbatimit bie mbi qeveritë lokale mbarë botën. Posaçërisht në rastin e OZHQ-ve, “qeveritë lokale janë politikë-bërës, katalizatorë të ndryshimit dhe të pozicionuar më së miri për të ndërlidhur qëllimet globale me komunitetet lokale.”<sup>3</sup>

Kompetenca komunale	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
Zhvillimi lokal ekonomik	
Planifikimi urban dhe rural	
Shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi	
Zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit	
Mbrojtja e mjedisit lokal	
Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të moshjes lokale	
Ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit	
Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut	
Ofrimi i përkujdesit publik primar shëndetësor	
Ofrimi i shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cëmueshit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale	
Banimi publik	
Shëndetësia publike	
Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirës publike	

Në tërësi, rreth 60% e zbatimit të OZHQ-ve bie mbi barrën e pushtetit lokal. 17 Objektivat, janë të zbërthyer në 169 Synime (Targete), prej të cilave 99 janë relevante për komunat e Kosovës. Ndërsa nga 242 indikatorë për matjen e zbatimit të këtyre targeteve, rreth 130 indikatorë janë relevant për komunat.

Nëse krahasojmë 17 Objektivat me 13 kompetencat kryesore komunale që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, shihet se secila prej këtyre kompetencave prekin një apo më shumë OZHQ. Rrjedhimisht, edhe 99 Synimet (Targetet) janë të zbatueshme nga komunat, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre veçse zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë nga komunat, siç konstatuar nga një punim i

realizuar nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) gjatë vitit 2022.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Shih ënë gjuhën angleze]:

[file:///C:/Users/Buton/Desktop/SDG%20Synims%20for%20Local%20Government/the\\_sdg\\_s\\_what\\_1\\_ocalgov\\_need\\_to\\_know\\_0.pdf](file:///C:/Users/Buton/Desktop/SDG%20Synims%20for%20Local%20Government/the_sdg_s_what_1_ocalgov_need_to_know_0.pdf)

<sup>4</sup> Shih Raportin në: <https://indep.info/wp-content/uploads/2022/10/OZHQ-te-perballe-fusheveprimtarise-dhe-misionit-te-Komunave-te-Kosoves-1.pdf>

Në përputhje me kompetencat e komunave që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, është zhvilluar edhe Sistemi për Monitorimin e Performancës Komunale (SMPK). Siç edhe specifikon Dokumenti i SMPM-së, "Përcaktimi i qëllimit të SMPK është i ndërlidhur me përcaktimet ligjore në fuqi" dhe "fushëveprimi i matjeve të SMPK-së shtrihet përgjatë brezit të kompetencave që kanë komunat sipas Ligjit 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale".<sup>5</sup>

Më tutje, i njejti dokumenton potencon se "matja e performancës bëhet me qëllim që të sigurojë monitorimin e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet matjeve të vlefshme të performancës, të ofrojë informata të nevojshme për lehtësimin e vendimmarrjes në komunë, të motivojë organet e pushtetit lokal dhe të promovojë përgjegjësinë dhe llogaridhënien gjatë punës së tyre në krijimin e kushteve për jetë të dinjitetshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës".<sup>6</sup>

Pra, i tërë fokusi i SMPK-së është të vlerësohet puna e komunave të Republikës së Kosovës në përmbushjen e kompetencave kryesore në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Në anën tjetër, siç u nënvizua më sipër, shumica prej këtyre kompetencave mbulojnë OZHQ-të përkatëse. Gjithashtu, u potencua përputhshmëria e plotë e OZHQ-ve me kapitujt e anëtarësimit në BE.

Mbi të gjitha, institucionet e Kosovës janë zotuar për të zbatuar OZHQ-të në Kosovë duke u bërë pjesë e iniciativës globale, pavarësisht se Kosova nuk është ende anëtare e Kombeve të Bashkuara. Në përputhje me këtë zotim, disa komuna janë bërë shembuj pozitiv të punës drejt përmbushjes së OZHQ-ve. Rastet më të theksuara janë Komuna e Drenasit, e cila ka bërë lokalizimin e OZHQ-ve, si dhe Komuna e Vushtrisë e cila tanimë ka hartuar Raportin e parë Vullentar Lokal.

Pavarësisht kësaj ndërlidhjeje të qartë të kompetencave kryesore komunale me OZHQ-të dhe zotimit politik të institucioneve të Kosovës, me rregullimin aktual që ka SMPK nuk mund të nxjerrë shumë të dhëna rreth përmbushjes së Targeteve të OZHQ-ve. Mirëpo, me një përditësim të SMPM-së mund të nxirren një numër i madh i të dhënave rreth përmbushjes së OZHQ-ve dhe Agjendës 2030. Kjo është e mundur pasi shumë prej aktiviteteve ditore të realizuara nga komunat e Republikës së Kosovës shkojnë drejt përmbushjes së OZHQ-ve, prandaj me një përditësim, përshtatje apo plotësim të SMPM-së mund të kapen dhe raportohen rezultatet e të gjitha këtyre aktiviteteve komunale.

Në seksionin në vijim do të bëhet një krahasim i indikatorëve të SMPK-së dhe indikatorëve të OZHQ-ve për të shfaqur përputhshmëritë si dhe shembuj të thjeshtë të përfshirjes së indikatorëve të OZHQ-ve brenda SMPK-së.

---

<sup>5</sup> Shih në: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale- designed-18.02.2021.pdf>

<sup>6</sup> Shih në: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Dokumenti-Kryesor-i-Sistemit-te-Menaxhimit-te-Performances-Komunale- designed-18.02.2021.pdf>

## Krahasim i indikatorëve të Sistemit të Menaxhimit të Performancës së Komunave me indikatorët e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Aktualisht, SMPK është i ndarë në 19 fusha të cilat mbulojnë kompetencat komunale sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Këto 19 fusha më tutje janë të zbërthyer në 37 rezultate. Dhe, për matjen e performancës komunale në zbatimin e kompetencave komunale janë përcaktuar 119 indikatorë.



Në anën tjetër, OZHQ-të kanë 17 Objektiva, 169 Synime (Targete) dhe 242 indikatorë. Prej tyre për komunat në Kosovë janë relevante 16 Objektiva, 99 Synime dhe 133 indikatorë.

Siç u theksuar më parë, aktualisht komunat, me përjashtim të Komunës së Vushtrisë nuk bëjnë vlerësim të përmbushjes së OZHQ-ve duke mbledhur të dhëna në bazë të indikatorëve të OZHQ-ve. Mirëpo, komunat bëjnë shumë projekte dhe aktivitete të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë përmbushin OZHQ-të, mirëpo mungon mbledhja e të dhënave dhe raportimi. Shumë të dhëna janë në dispozicion apo mund të mblidhen lehtë nga komunat të cilat mund të ofrojnë pasqyrë të qartë të përmbushjes së OZHQ-ve.


Duke marrë parasysh se SMPK është dëshmuar si një sistem i suksesshëm për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave nga ana e komunave, plotësimi i këtij sistemi me një numër të indikatorëve të OZHQ-ve është një zgjidhje adekuate për të përmirësuar situatën jo të mirë rreth përmbushjes së OZHQ-ve. Mbi të gjitha, një punë e konsiderueshme që e bëjnë komunat përmbushin gradualisht OZHQ-të, por për shkak të mungesës së koordinimit dhe raportimit strukturor e gjithë kjo punë shkon e pavërejtur.

Gjithashtu, duke marrë parasysh që për zbatim të OZHQ-ve kërkohet angazhim i të gjithë komunitetit e jo vetëm institucioneve, në qarqet akademike dhe të organizatave ndërkombëtare rekomandohet të bëhet edhe mbledhja e të dhënave jozyrtare rreth përmbushjes së OZHQ-ve. Të dhënat jozyrtare mund të mblidhen nga komuniteti i biznesit, organizatat joqeveritare, academia, asociacionet kulturore dhe sportive dhe ngjashëm.



Më poshtë në formë tabelare janë dhënë disa nga Fushat dhe indikatorët e SMPK dhe OZHQ-të dhe indikatorët përkatës. Në pjesën e parë të tabelës është dhënë gjendja aktuale do të thotë indikatorët e OZHQ-ve që drejtpërdrejt ose tërthorazi mbuloohen nga indikatorët e SMPK-së, ndërsa në pjesën e dytë të tabelës janë shtuar indikatorët e OZHQ që mund të përfshihen si rrjedhojë e një plotësimi ose përditësimi të SMPK-së të propozuar.

Fusha e SPMK	OZHQ-të mbuluara	Indikatorët SPMK	Indikatorët e mbuluar të OZHQ-ve
Fusha 4 Barazia në Punësim, Shërbime	 	4.1.1 - Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	1.3.1 Proporcioni i popullsisë së mbuluar nga skemat e mbrojtjes sociale, sipas gjinisë, me përparësi fëmijët, personat e papunë, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna,





<p>Sociale dhe Familjare</p>		<p>4.1.2 - Të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë</p> <p>Treguesi 4.2.1 - Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social</p> <p>4.2.2 - Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar</p>	<p>të sapolindurit, viktimat e lëndimeve në punë dhe të varfërit, apo grupet e tjera të marginalizuara</p> <p>1.a.2 Proporcioni i shpenzimeve totale të qeverisë për shërbimet bazike (arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale)</p> <p>8.5.2 Shkalla e papunësisë, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara</p> <p>16.7.1 Proporcionet e pozitive në institucionet kombëtare dhe lokale, përfshirë (a) legjislativat; (b) shërbimin publik; dhe (c) gjyqësorin, krahasuar me shpërndarjet kombëtare, sipas gjinisë, moshës, personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të popullsisë</p>
<p>Fusha e SPMK</p>	<p>OZHQ-të pambuluara</p>	<p>e Indikatorët e SPMK</p>	<p>Indikatorët e pambuluara të OZHQ-ve</p>
<p>Fusha 4</p> <p>Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare</p>		<p>4.1.1 - Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale</p> <p>4.1.2 - Të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë</p> <p>Treguesi 4.2.1 - Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social</p> <p>4.2.2 - Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar</p>	<p>1.2.1 Proporcioni i popullsisë që jeton nën limitin kombëtar të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës</p> <p>2.1.1 Prevalenca e nënushqyerjes</p> <p>2.2.1 Prevalenca e stagnimit në zhvillim (lartësia për moshën &lt;-2 devijimi standard nga mesatarja e Standardeve të Rritjes së Fëmijëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh)) tek fëmijët nën 5 vjeç</p> <p>2.2.2 Prevalenca e kequshqyerjes (pesha për gjatësi &gt; +2 ose &lt;-2 devijimi standard nga mesatarja e Standardeve të Rritjes së Fëmijëve të OBSh) midis fëmijëve nën 5 vjeç, sipas llojit (humbje dhe mbipeshë)</p> <p>10.2.1 Përqindja e njerëzve që jetojnë nën 50 përqind të të ardhurave mesatare, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara</p> <p>10.3.1 Përqindja e raportimit të popullsisë/personave që personalisht janë ndjerë të</p>

			<p>diskriminuar ose ngacmuar në 12 muajt e mëparshëm në bazë të një arsye diskriminimi të ndaluar sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut</p> <p>11.1.1 Përqindja e popullsisë urbane që jeton në lagje të varfra, vendbanime joformale ose banesa të papërshtatshme</p> <p>16.2.1 Përqindja e fëmijëve të moshës 1–17 vjeç që kanë përjetuar ndonjë ndëshkim fizik dhe / ose agresion psikologjik nga kujdestarët gjatë muajit të kaluar</p>
--	--	--	--

Fusha e SPMK	OZHQ-të mbuluara	Indikatorët e SPMK	Indikatorët e mbuluar të OZHQ-ve
Fusha 12 Uji i pijshëm		12.1.1 - Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjesit 12.1.2 - Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	1.4.1 Proporcioni i popullsisë që jeton në ekonomi familjare me qasje në shërbime bazike  6.1.1 Përqindja e popullsisë që përdor shërbime të ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt
Fusha e SPMK	OZHQ-të pambuluara	Indikatorët e SPMK	Indikatorët e pambuluar të OZHQ-ve
Fusha 12 Uji i pijshëm		12.1.1 - Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjesit 12.1.2 - Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në	3.9.2 Shkalla e vdekshmërisë i atribuohet ujit të pasigurt, higjienës së pasigurt dhe mungesës së higjienës (ekspozimi ndaj shërbimeve të pasigurta të ujit dhe higjienës për të gjithë (WASH))  6.2.1 Përqindja e popullsisë që përdor (a) shërbime higjienike të administruara në mënyrë të sigurt dhe (b) një ambient për larjen e duarve me ujë dhe sapun

<sup>7</sup> OZHQ 6 është futur edhe nën të "pambluarat" pasi është vetëm pjesërisht e mbuluar me indikatorët aktual të SPMK

		sistemin e ujit të pijshëm	<p>6.6.1 Ndryshimi në shtrirjen e ekosistemeve të lidhura me ujin me kalimin e kohës</p> <p>6.a.1 Shuma e ndihmës zyrtare për zhvillimin e lidhur me ujin dhe kanalizimet që është pjesë e një plani shpenzimesh të koordinuara nga qeveria</p> <p>6.b.1 Proporcioni i njësive administrative lokale me politikat dhe procedurat e vendosura dhe operacionale për pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve</p>
--	--	----------------------------	--

Fusha e SPMK	OZHQ-të mbuluara	Indikatorët e SPMK	Indikatorët e mbuluar të OZHQ-ve
Fusha 15 Mbrojtja e Mjedisit		<p>15.1.1 - Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis</p> <p>15.1.2 - Lejet mjedisore komunale të lëshuara</p> <p>15.1.3 - Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale</p>	<p>15.1.1 Zona pyjore si pjesë e sipërfaqes totale të tokës</p> <p>15.3.1 Proporcioni i tokës që është degraduar mbi sipërfaqen totale të tokës</p>
Fusha e SPMK	OZHQ-të pambuluara	Indikatorët e SPMK	Indikatorët e pambuluar të OZHQ-ve
Fusha 15 Mbrojtja e Mjedisit		<p>15.1.1 - Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis</p> <p>15.1.2 - Lejet mjedisore komunale të lëshuara</p>	<p>7.1.2 Proporcioni i popullsisë me mbështetje primare në lëndët djegëse të pastra dhe teknologjinë</p> <p>11.6.2 Nivelet mesatare vjetore të grimcave të imëta (p.sh. PM2.5 dhe PM10) në qytete (popullsia e matur)</p> <p>12.4.2 (a) Mbetjet e rrezikshme të krijuara për kokë banori; dhe (b)</p>

<sup>8</sup>OZHQ 15 është futur edhe nën të "pambluarat" pasi është vetëm pjesërisht e mbuluar me indikatorët aktual të SPMK

		<p>15.1.3 - Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale</p>	<p>përqindja e mbetjeve të rrezikshme të trajtuara, sipas llojit të trajtimit</p> <p>12.5.1 Shkalla kombëtare e riciklimit, ton materiale të ricikluara</p> <p>12.6.1 Numri i kompanive që publikojnë raporte të qëndrueshmërisë</p> <p>12.b.1 Zbatimi i mjeteve standarde të kontabilitetit për të monitoruar aspektet ekonomike dhe mjedisore të qëndrueshmërisë së turizmit</p> <p>15.2.1 Progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve</p> <p>15.a.1 (a) Ndihma zyrtare e zhvillimit për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit; dhe (b) të ardhurat e gjeneruara dhe financat e mobilizuara nga instrumentet ekonomike që kanë të bëjnë me biodiversitetin</p>
--	--	---	--

## Përfundime dhe rekomandime

Punimi nënvizoi funksionimin e Sistemit për Menaxhim të Performancës së Komunave si një shembull i suksesit për të nxitur komunat të angazhohen në përmbushjen e kompetencave ligjore si dhe në zbatimin sa më të mirë të parimeve demokratike. Njëkohësisht, mbledhja e të dhënave përmes treguesve të përcaktuar është vendimtar në arritjen e këtij suksezi.

Më tutje, punimi potencoi zotimet e institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e agjendave dhe politikave globale dhe evropiane si OZHQ-të dhe Agjenda e Gjelbër të cilat janë miratuar për të adresuar sfidat bashkëkohore me të cilat ballafaqohen shtetet. Po ashtu, u evidentua lidhmëria dhe përputhshmëria ndërmjet 35 Kapitujve të Anëtarësimit në BE, Agjendës së Gjelbër Evropiane, Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe kompetencave të komunave sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Duke marrë parasysh zotimet e institucioneve të Republikës së Kosovës për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe suksesin e SMPK-së, punimi propozon që shqyrtohet mundësia e përfshirjes së indikatorëve të OZHQ-ve brenda këtij sistemi në mënyrë që Republika e Kosovës të raportojë progresin drejt përmbushjes së zotimeve ndërkombëtare siç janë OZHQ-të dhe Agjenda e Gjelbër Evropiane.

Po ashtu, përgjatë punimit u theksua se shumica e OZHQ-ve janë përgjegjësi e pushtetit lokal në të gjithë botën, dhe rrjedhimisht edhe për komunat e Republikës së Kosovës. Mbi të gjitha u potencua se komunat e Kosovës veçse zbatojnë një numër të konsiderueshëm të këtyre synimeve por zbatimi i tyre nuk raportohet. Prandaj, përfshirja e indikatorëve të OZHQ-ve brenda SMPK-së do të ishte qasja më efikase që institucionet e Republikës së Kosovës të raportojnë për përmbushjen e OZHQ-ve.

Nga analiza dhe vlerësimet e bëra përgjatë punimit, janë konstatuar dy opsione për të përfshirë indikatorët e OZHQ-ve brenda SMPK-së: i) *përditësimi ose plotësimi i treguesve ekzistues të SMPK*; dhe ii) *rishikimi i fushave dhe treguesve të SMPK-së*.

Opsioni i parë do të nënkuptonte përditësim ose plotësim të treguesve ekzistues të SMPK-së duke përfshirë një numër të selektuar të indikatorëve të OZHQ-ve pa ndonjë ndryshim thelbësor. Sipas këtij opsioni, do të bëhej një krahasim dhe analizim i kujdesshëm i të gjithë treguesve të SMPK-së përballë OZHQ-ve dhe indikatorëve përkatës, dhe si rezultat do të shtoheshin indikatorët relevant të OZHQ-ve si pjesë e treguesve të SMPK-së. Një krahasim i tillë i thjeshtë është dhënë në faqet 6 deri në 9 si metodë që mund të ndiqet për të përditësuar ose plotësuar SMPK-në. Duhet ritheksuar se një përditësim/plotësim i tillë nuk do të sjellë punë shtesë për komunat, sepse shumë prej këtyre punëve janë duke i bërë dhe shumicën e të dhënave veçse i kanë në dispozicion apo mund t'i marrin lehtësisht.

Opsioni i dytë, *rishikimi i fushave dhe treguesve të SMPK-së* do të nënkuptonte ndryshim apo rikategorizim të 19 Fushave, rezultateve dhe të treguesve të SMPK-së përballë Objektivave dhe Synimeve (Targeteve) të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë ndryshim thelbësor i fushave, rezultateve apo treguesve, por një rishikim për të shkrirë disa prej fushave dhe për të përfshirë ndonjë fushë të re, në bazë të sfidave dhe trendeve bashkëkohore.

Për shembull, Fusha 1: Shërbimet Publike Administrative, Fusha 2: Transparenca Komunale dhe Fusha 3: Përgjegjshmëria Komunale mund të shkrihen në dy fusha, pasi që disa prej treguesve nga Fusha 1 dhe 3 janë kombinim i punës së brendshme administrative, ndërsa disa prej treguesve të Fushave 2 dhe 3 janë kombinim i transparencës dhe konsultimit me publikun.

Më pas, Fusha 6 Menaxhimi i Fatkeqësive dhe Fusha 15 Mbrojtja e Mjedisit mund të shkrihen në një fushë, pasi të dy fushat kanë në fokus kryesor intervenimet në mjedis me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe jetës së qytetarëve. OZHQ 13 është e dizajnuar në atë mënyrë që ndërlidh fatkeqësitë me ndryshimet klimatike, si rrjedhojë e dëmtimit të mjedisit. Për më tepër, edhe organizatat ndërkombëtare në shumë raste i trajtojnë këto fusha brenda një komponente.

Për më shumë, Fusha 7 Planifikimi Hapsinor dhe Fusha 8 Hapësirat Publike gjithashtu mund të shkrihen në një fushë pasi janë thellësisht të ndërlidhura. E njëjta gjë mund të bëhet edhe me Fushën 12 Uji i Pijshëm dhe Fushën 13 Kanalizimi, duke i shkruar në një fushë.

Një rishikim i tillë, do të linte hapsirë për futjen e disa fushave të reja në SMPK në përputhje me trendet globale dhe zotimet e institucioneve të Republikës së Kosovës. Për shembull, mund të përfshihen fusha të reja si: Energjia e Ripëtrirshme, Siguria në Ushqim, Inovacioni, Shfrytëzimi Adekuat i Tokave Bujqësore dhe Prodhimtaria, dhe të ngjashme. Dhe prapë, edhe me përfshirjen e fushave të reja nuk do të ndryshonte numri i fushave. Me gjasë, do të rritej lehtë numri i treguesve për të evidentuar më shumë punët që janë duke i bërë komunitat.

Cilido opsion që zgjidhet dhe aplikohet duhet të reflektohet në programin Content Management System (CMS) si platformë softuerike për të raportuar përmbushjen e treguesve.

Në përputhje me konkluzionet e mësipërme, institucioneve vendimmarrëse, dhe në veçanti Ministrisë së Pushtetit Lokal si administrator i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale iu rekomandohet ndërmarrja e veprimeve për të zbatuar njërin prej dy opsioneve të rekomanduara më poshtë:

Inicimi i rishikimit të fushave dhe treguesve të Sistemit për Menaxhim të Performancës së Komunave. Duke pasur parasysh se një funksionim i mirëfilltë i Sistemit për Menaxhim të Performancës së Komunave është akselator për angazhimin e komunave në zbatimin sa më të mirë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe Agjendës 2030, duhet të iniciohet përditësimi ose plotësimi i treguesve ekzistues në Sistemin për Menaxhim të Performancës së Komunave. Kjo përfshin krahasimin dhe vlerësimin e treguesve të SMPK-së përballë indikatorëve të OZhQ-ve, përfshirjen e indikatorëve të OZhQ-ve të selektuar, si pjesë përbërëse e treguesve të SMPK-së, si dhe përditësimin e programit Content Management System (CMS) për të reflektuar konkludimet e iniciativës.

Inicimi i rishikimit të fushave dhe treguesve të SMPK-së, e cila përfshin vlerësimin dhe analizimin e fushave, rezultateve dhe treguesve të SMPK-së përballë objektivave, synimeve (targeteve dhe indikatorëve të zhvillimit të qëndrueshëm, shkruarjen e disa prej fushave dhe futjen e disa fushave të reja për të adresuar sfidat dhe trendet bashkëkohore dhe përditësimin e programit CMS për të reflektuar konkludimet e iniciativës.



Ky projekt financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).